

VENDIM
Nr. 670, datë 3.10.2012

**PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT NË ROMË, ITALI, TË DISA OBJEKTEVE TË RRALLA ME
VLERA UNIKE, NË KUADËR TË REALIZIMIT TË EKSPOZITËS “THESARE TË KULTURËS
SHQIPTARE”, NGA DATA 20 NËNTOR 2012 DERI MË 6 JANAR 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit në Romë, Itali të disa objekteve të rralla me vlera unike, në kuadër të realizimit të ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri më 6 janar 2013, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” të kryejë shoqërimin dhe kthimin e ikonave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha